



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 795/24 Dt. 31.12.2024



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

## Plani Punës 2025

Të dashur bashkëqytetarë,

Viti 2025 shënon një mundësi të re për ta avancuar vizionin tim dhe të ekipit tim drejt një Prizreni më të mirë, në bashkëpunim të ngushtë me qytetarët tanë. Si Kryetar i Komunës, jam i përkushtuar që, së bashku me ekipin tim, të vazhdojmë me projekte konkrete dhe të qëndrueshme që përmirësojnë cilësinë e jetës në qytet.

Fokusi ynë mbetet në zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës, fuqizimin e jetës kulturore dhe sportive si dhe krijimin e mundësive të reja për qytetarët. Angazhimi ynë është t'i ruajmë traditat e pasura të Prizrenit, duke i kombinuar me inovacionin dhe zhvillimin modern për të ndërtuar një qytet që frymëzon dhe ofron mundësi për të gjithë.

Duke besuar në potencialin dhe energjinë e komunitetit tonë, synoj që së bashku të bëjmë hapa vendimtarë drejt një Prizreni më të zhvilluar, gjithëpërfshirës dhe të denjë për të ardhmen.

## OBJEKTIVAT E PROGRAMIT QEVERISËS PËR VITIN 2025

### 1. Menaxhimi Efektiv i Resurseve Humane dhe Financave Publike

- Përmirësimi i performancës së stafit komunal përmes trajnimeve dhe motivimit.
- Menaxhimi i buxhetit me transparencë dhe efikasitet për ta maksimizuar ndikimin në projekte zhvillimore.

### 2. Promovimi i prosperitetit ekonomik në të gjitha zonat e Komunës

- Mbështetja e bizneseve lokale dhe nxitja e investimeve private dhe publike.

### 3. Ngritja e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet

### 4. Modernizimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale

- Hapja e qendrave të reja shëndetësore dhe përmirësimi i pajisjeve ekzistuese.

- Rritja e qasjes dhe cilësisë së shërbimeve për shtresat më të ndjeshme të shoqërisë.

#### **5. Zhvillimi i infrastrukturës dhe urbanistikës**

- Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, trotuareve dhe rrjeteve të kanalizimeve.
- Zhvillimi i zonave të reja urbane duke respektuar planifikimin urbanistik dhe mjedisor.

#### **6. Prizreni i gjelbër: Qytet i qëndrueshëm dhe miqësor me mjedisin**

- Shtimi i hapësirave të gjelbra dhe mbjellja e pemëve në zona urbane dhe rurale.
- Promovimi i energjive të ripërtërishme dhe zbatimi i projekteve për menaxhimin e mbeturinave.

#### **7. Zhvillimi i rinisë, kulturës dhe sportit**

- Investime në hapësirat sportive, kulturore dhe në aktivitete që promovojnë kreativitetin rinor.
- Organizimi i festivaleve dhe ngjarjeve ndërkombëtare për ta nxitur pjesëmarrjen dhe njohjen globale.

#### **8. Rregullimi dhe ruajtja e Qendrës Historike**

#### **9. Nxitja e turizmit si sektor strategjik**

- Hartimi i strategjive për ta promovuar Prizrenin si destinacion turistik të qëndrueshëm.
- Zhvillimi i infrastrukturës turistike dhe përmirësimi i shërbimeve për vizitorët.

Aktivitetet drejt arritjes së objektivave do të bëhen nga drejtoritë përkatëse, stafi profesional i drejtorive, zyret përgjegjëse dhe stafi i kabinetit tim. Ky plan është një dokument dinamik i cili mund të ndryshoj në vazhdimësi sipas nevojave, kërkesave dhe ngjarjeve.

## **KABINETI & ZYRET E KRYETARIT**

### **Objektivat Strategjike të Kabinetit dhe Zyreve të Kryetarit të Komunës së Prizrenit**

#### **1. Qeverisje transparente dhe pjesëmarrëse**

- Sigurimi i qasjes së lehtë në informacione dhe llogaridhënia përmes dëgjimeve dhe takime konsultative me qytetarët.
- Menaxhimi i transparencës dhe performancës përmes indikatorëve të matshëm.

## 2. Menaxhimi i prokurimeve dhe projekteve kapitale

- Sigurimi i transparencës dhe raportimit periodik për planin e prokurimit dhe proceset përkatëse.
- Zbatimi i Ligjit të Prokurimit Publik dhe përputhshmëria me planifikimet e drejtorive për projektet kapitale.

## 3. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe performancës së administratës

- Informimi i qytetarëve për konkurset e punës, rezultatet dhe trajtimin dinjitoz të ankesave.
- Menaxhimi dhe monitorimi i performancës së stafit në të gjitha drejtoritë dhe njësitë përkatëse.

## 4. Zbatimi i ligjeve dhe përputhshmëria me aktet rregullative

- Sigurimi i funksionimit të proceseve në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje, Statutin e Komunës dhe aktet e tjera nënligjore.
- Realizimi i veprimeve dhe aktiviteteve në përputhje me Agjendën Evropiane për Integritet Evropian.

## 5. Bashkëpunim dhe zhvillim ndërinstytucional

- Realizimi i projekteve dhe bashkëpunimeve me komunitatet e tjera brenda dhe jashtë Kosovës si dhe me organizatat ndërkombëtare.
- Inicimi dhe aplikimi për fonde, grante dhe projekte të ndryshme zhvillimore.

## 6. Auditimi dhe përmirësimi i proceseve

- Realizimi i auditimeve sipas ligjeve në fuqi përmes Zyrës së Auditimit të Brendshëm.

## 7. Promovimi i barazisë dhe gjithëpërfshirjes

- Sigurimi i barazisë, gjithëpërfshirjes dhe trajtimit të barabartë për të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën tonë.

## 8. Zhvillimi i projekteve me ndikim ekonomik dhe social

- Menaxhimi dhe realizimi i projekteve me karakter zhvillimi për të krijuar perspektiva të reja dhe qasje prosperuese për komunën.



Këto objektiva do të shërbejnë si bazë për realizimin e planit të punës së Komunës së Prizrenit dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

#### **Planifikimi sipas drejtorive:**

##### **1. Drejtoria e Arsmi dhe Shkencës**

Drejtoria e Arsimi për vitin 2025 ka si qëllim përmirësimin dhe zhvillimin e sistemit arsimor në komunë. Ky plan është ndarë në shtatë objektiva strategjike, të cilat janë të fokusuara në fushat kyçe të arsimit dhe menaxhimit të institucioneve edukative. Çdo objektiv është mbështetur nga masa dhe aktivitete konkrete që duhet të realizohen për t'i arritur objektivat e përcaktuara.

#### ***Objektivat Strategjike:***

*Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës*

- Funksionalizimi dhe Fuqizimi i Këshillave Drejtuese të Shkollave
- Ngritja e Kapaciteteve për Udhëheqje dhe Menaxhim
- Ndërtimi i Strukturës për Menaxhim Efektiv të Arsimi në DKA
- Krijimi i Mekanizmave për Vlerësim dhe Stimulim të Strukturave Udhëheqëse të Shkollave
- Rishikimi dhe Racionalizimi i Rrjetit të Shkollave në Komunë

*Mjedisi shkollor i përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtë mësimore*

- Analiza e gjendjes së sigurisë në shkolla dhe marrja e masave për plotësimin e nevojave më prioritare
- Ndërtimi i terreneve dhe i sallave të edukatës fizike
- Hartimi i planit për mirëmbajtje teknike të shkollave

*Përmirësim domethënës i cilësisë së mësimdhënies dhe të të nxëniti në shkolla*

- Fuqizimi i modelit "komuniteti i të mësuarit së bashku"
- Pajisja e shkollave me mjete të TIK-ut dhe rrjeteve lokale
- Furnizimi i shkollave me mjete elementare të konkretizimit (0-5)
- Pajisja e shkollave me kabinete dhe laboratorë të ndryshëm

*Ndërtimi i vazhdueshëm i kapacitetit për mësimdhënie cilësore*

- Identifikimi i nevojave të mësimdhënësve për trajnime
- Organizimi i trajnimeve në nivel të komunës dhe me bazë në shkollë
- Nxitja e monitorimit dhe shkëmbimit të përvojave në mes të kolegëve



- Themelimi i Qendrës Didaktike dhe mbështetja e qendrës për ngritje profesionale
- Krijimi i mekanizmave efikas për financimin e Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve
- Angazhimi i drejtorëve të shkollave për monitorim të vazhdueshëm të mësimdhënësve lidhur me zbatimin e metodologjive bashkëkohore
- Ngritja e kapaciteteve të shkollës për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve
- Krijimi i mekanizmave funksionalë për stimulim të mësimdhënësve të suksesshëm

*Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies në shkolla*

- Përkrahja e koordinatorëve të cilësisë me bazë në shkollë
- Caktimi i fondeve për ndërtim, renovim, zgjerim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës shkollore
- Furnizimi i shkollave me kompjuterë dhe infrastrukturë të TIK-ut dhe mjeteve të tjera të nevojshme
- Pajisje me pako të veglave për lëndën e edukatës fizike
- Ndërtimi dhe fuqizimi i mekanizmave për sigurimin e cilësisë në nivel të shkollës dhe të komunës
- Fuqizimi i aktiviteteve profesionale në shkolla

*Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të hisedarëve të edukimit të hershëm*

- Stimulimi i hapjes së institucioneve të edukimit parashkollor përmes partneriteteve publiko-private
- Bashkëpunimi me MASHT/SIA për licencimin e IPEH
- Ndërgjegjësimi i komunitetit për përfshirje në edukimin e hershëm dhe parafillor
- Bashkëpunim i shtuar me institucionet private të edukimit të hershëm

*Ndërlidhja më e mirë e arsimit profesional me tregun e punës*

- Identifikimi i nevojave të tregut të punës
- Përshtatja e kurrikulave dhe programeve të studimit
- Pjesëmarrja aktive e industrisë në procesin mësimor
- Monitorimi dhe vlerësimi i efikasitetit të trajnimit

## **2. Drejtoria e Administratës**

Plani i punës për Drejtorinë e Administratës përfshin sektorin e gjendjes civile, sektorin e IT-së dhe aktivitete të tjera e investime kapitale.

Drejtorja e Administratës do të vazhdojë me aktivitetet e saj për trajnimin e zyrtarëve komunalë, për përmirësimin e shërbimeve si dhe harmonizimin e vendeve të punës e funksionimin e administratës.

*Investimet Kapitale*

- Renovimi i disa objekteve të Komunës

- Ndërtimi i memorialit në fshatin Krushë e Vogël
- Blerja e automjeteve zyrtare për nevojat e Komunës

#### *Sektori i Gjendjes Civile*

- Shërbim efikas dhe i shpejtë për qytetarët, përfshirë certifikatat dhe kërkesat e ndryshme.
- Inspektimi dhe monitorimi i punës së zyrtarëve në OSS dhe zyrat e vendit.
- Bashkëpunimi me drejtoritë dhe institucionet brenda dhe jashtë komunës.
- Promovimi dhe përdorimi i platformës digjitale e-Kosova për shërbime elektronike.
- Përmirësimi i performancës së zyrtarëve dhe administratës komunale.

#### *Zyra e Teknologjisë së Informacionit*

- Mirëmbajtja dhe zhvillimi i softuerëve dhe harduerëve.
- Investime në pajisje elektronike për zëvendësimin e kompjuterëve të vjetër dhe asgjësimin e pajisjeve të vjetra.
- Përmirësimi i rrjetit lokal (LAN/WAN) për mbështetje të zyrtarëve dhe përdorimin e sistemeve qeveritare si Intranet, e-Pasuria, e-Depoja, etj.

#### *Investimet për 2025 (IT)*

- Furnizim me kompjuterë dhe pajisje të tjera për zëvendësimin e pajisjeve të vjetra.
- Mirëmbajtja e rrjetit LAN/WAN, me fokus në lidhjet mes ndërtesave të Komunës.
- Mbështetje për sistemet qeveritare dhe e-mail-ët zyrtarë.

Ky plan i detajuar ka një qasje të gjithanshme për zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve publike dhe administratës lokale.

### **3. Drejtoria e Shëndetësisë**

Drejtoria e Shëndetësisë, bazuar në buxhetin e planifikuar për vitin 2025, ka paraparë realizimin e projekteve kryesore dhe arritjen e objektivave si në vijim:

#### *Investimet kapitale:*

- Vazhdimi i ndërtimit të QKMF-së (kampi i ish-KFOR-it gjerman).
- Ndërtimi i QMF-së në Lagjen e Trimave (Tusus) dhe AMF-së në Vlashnje.
- Furnizimi me aparatura mjekësore, laboratorike, stomatologjike dhe mamografi.
- Blerja e autoambulancave dhe pajisjeve jo mjekësore.
- Instalimi i ngrohjes qendrore dhe klimatizimit.

#### *Mallrat dhe shërbimet:*

- Furnizimi me barna, reagenca laboratorike dhe materiale mjekësore.

- Renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore.
- Trajnimi i stafit dhe sigurimi fizik i objekteve.
- Realizimi i shërbimeve administrative dhe logjistike.

*Shërbimet shëndetësore:*

- Ofrimi i kujdesit parësor, vizitave specialistike dhe shërbimeve diagnostike.
- Shërbimet urgjente, stomatologjike, vaksinimi dhe kujdesi për nënat e fëmijët.

*Ditët botërore dhe aktivitete ndërgjegjësuese:*

- Shënimi i ditëve botërore sipas kalendarit shëndetësor në bashkëpunim me IKSHP-në.

*Subvencionet:*

- Mbështetje financiare për kategoritë përfituese, me një buxhet të parashikuar prej 600,000.00 eurove.

Drejtoria do të vazhdojë t'i përshtasë planifikimet dhe aktivitetet sipas nevojave të komunitetit dhe situatave të paraqitura gjatë vitit.

#### **4. Drejtoria e Financave**

Plani i punës për Drejtorinë e Financave për vitin 2025 fokusohet në garantimin e menaxhimit efikas të burimeve financiare të Komunës, duke përmirësuar proceset e planifikimit buxhetor, mbikëqyrjes financiare dhe transparencës, si dhe duke siguruar që shpenzimet publike të jenë të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

*Spektori i Tatimit në Pronë*

Janar:

- Përgatitja e raporteve vjetore.
- Verifikimi i objekteve në terren.
- Pranimi dhe shqyrtimi i ankesave për pronën e paluajtshme.
- Verifikimi i ankesave në terren.

Shkurt – Mars:

- Vazhdimi i verifikimit dhe regjistrimit të objekteve gjatë tërë vitit.
- Fillimi i procedurave për inkasimin e detyrueshëm.



Prill – Maj:

- Shpërndarja e faturave.
- Përgatitja dhe shpërndarja e vendimeve për ankesat dhe kërkesat e pronës së paluajtshme.

Qershor – Shtator:

- Përgatitja e raporteve gjashtëmujore.
- Vazhdimi i verifikimit të objekteve në terren.

Tetor – Dhjetor:

- Miratimi i vendimit për shkallën tatimore.
- Përgatitja e raporteve vjetore.
- Finalizimi i procedurave për inkasimin e detyrueshëm.

#### *Spektori i Buxhetit dhe Planifikimit*

Janar – Mars:

- Përgatitja e pasqyrave financiare për vitin 2024.
- Trajnimi i drejtorëve dhe menaxherëve për buxhetin 2025.
- Hartimi i strategjive dhe listave të rreziqeve.
- Përgatitja e raportit të subvencioneve për Zyrën e Kryeministrit.

Prill – Qershor:

- Organizimi i debatit publik për planifikimin e buxhetit 2026.
- Rishikimi i buxhetit 2025 dhe koordinimi me MF-në për qarkoret e reja.

Korrik – Shtator:

- Raportimi Janar-Qershor 2025.
- Njoftimi i drejtorive për limitet kohore për zotimet e mjeteve.

Tetor – Dhjetor:

- Përgatitja finale e buxhetit 2026-2028 për miratim.
- Futja e të dhënave në sistemin BDMS-së dhe SIMFK-së.

#### *Financat dhe Kontabiliteti*

Aktivitetet kryesore gjatë gjithë vitit:

- Përgatitja e pasqyrave financiare dhe barazimet me thesarin.
- Regjistrimi i shpenzimeve dhe përgatitja e alokimeve.

- Barazimi tremujor me MEF-në për HV-në dhe shpenzimet.
- Skanimi dhe arkivimi i lëndëve.

#### *Qendra për Regjistrim të Bizneseve (QKB/ARBK)*

##### Raportimi Periodik:

- Raportime mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe nëntë mujore.
- Njoftimet për çregjistrimin e bizneseve.

Ky plan ka fokus në menaxhimin e tatimeve, buxhetit, financave dhe raportimeve për sektorët përkatës.

### **5. Drejtoria e Shërbimeve Publike**

DSHP-ja kontribuon në ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore, kanalizimeve, ujësjellësve dhe ambienteve publike. Plani i punës për vitin 2025 është përpiluar në përputhje me detyrat dhe angazhimet e DSHP-së si dhe planifikimet për periudhën 2025–2027. Fokusi është në:

- Zbatimin e projekteve për investime kapitale;
- Mirëmbajtjen e projekteve ekzistuese;
- Organizimin e aktiviteteve të ndryshme të financuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- Përgjigjen ndaj kërkesave të qytetarëve dhe drejtorive tjera.

Qëllimet kryesore të DSHP-së për vitin 2025 janë:

*Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve dhe infrastrukturës*

Objektivat dhe Aktivitetet:

- Rregullimi i rrugëve dhe trotuareve në Lagjen "2 Korriku";
- Ndërtimi i infrastrukturës (rrugë, kanalizim, ujësjellës) në lagjen "Jeta e Re";
- Ndërtimi i projekteve infrastrukturore në lagjet Tabakhane, Bazhdarhane, Ortakoll, Bajram Curri;
- Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën "Operacioni Shigjeta";
- Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në lagjen "Arbana";
- Rehabilitimi i Stacionit të Autobusëve dhe renovimi i objektit;
- Rehabilitimi i rrugëve me kubëza, trotuareve dhe shesheve në Ortakoll, Bajram Curri, Arbana, Jeta e Re;
- Rehabilitimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në pjesët kryesore të qytetit;
- Ndërtimi i Tregut të Gjëlber dhe parkingut nëntokësor pranë Gjimnazit;
- Faza e dytë e ndërtimit të infrastrukturës në lagjen "Bajram Curri";
- Ndërtimi i objektit të Komunës dhe parkingjeve pranë "Shtëpia e Bardhë";
- Instalimi dhe riparimi i ndriçimit publik në lagjet dhe fshatrat kryesore.

### *Krijimi i kushteve për kthimin e qytetarëve dhe bizneseve në zonat rurale*

#### Objektivat dhe Aktivitetet:

- Ndërtimi i rrugës Shpenadi-Lubizhdë;
- Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në fshatrat e Zhupës;
- Rregullimi i trotuarit dhe kanalizimit në Bregdri;
- Ndërtimi i rrugës alternative Lubizhdë-Skorobisht;
- Ndërtimi i rrugës Shkolla e Re-Karakolla;
- Faza e dytë e ndërtimit të rrugës Qafa e Kushninit-Stanet e Struzhës;
- Ndërtimi i mureve mbrojtëse në zonat rurale;
- Ndërtimi i urës në fshatin Zojz;
- Kubëzimi dhe ndriçimi publik në Vërmicë;
- Ndërtimi i një pike publike të kompostimit;
- Ndërtimi i rrugës kryesore në Lubizhdë të Prizrenit.

### *Shtimi i kapacitetit të ujit të pijes dhe sistemimi i ujërave të ndotura*

#### Objektivat dhe Aktivitetet:

- Rritja e kapacitetit të ujit të pijës në lagje dhe zona të ndryshme;
- Rehabilitimi i sistemit të ujërave të ndotura.

### *Siguria e përgjithshme*

#### Objektivat dhe Aktivitetet:

- Instalimi dhe riparimi i ndriçimit publik në lagjet kryesore dhe fshatrat periferike.

### *Qytet i gjelbër dhe menaxhim i mbeturinave*

#### Objektivat dhe Aktivitetet:

- Projekte ambientale në qytet dhe lagjet përreth.

### *Rregullimi i komunikacionit*

#### Objektivat dhe Aktivitetet:

- Rregullimi i udhëkryqeve në zona të ndryshme;
- Ndërtimi i rreth rrotullimeve.

### *Aktivitetet ndihmuese*

#### Objektivat dhe Aktivitetet:



- Hartimi i projekteve dhe inçizimeve gjeodezike;
- Investimi në mobilieri urbane dhe hapësira publike;
- Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit;
- Festat mjedisore;
- Furnizimi me kontejnerë dhe pajisje tjera;
- Pastrimi i pusetave dhe rrjetit të kanalizimit;
- Trajtimi dhe rrethimi i hapësirave publike;
- Mbjellja dhe inventarizimi i fidaneve drunore.

## 6. Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor

Objektivat kryesore që ndërlidhin planin buxhetor dhe punën e drejtorisë janë:

*Hartimi dhe përditësimi i planeve urbane dhe zhvillimore*

- Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK).
- Hartimi i Planit Rregullues Urban për zonën e veçantë – Parku i Biznesit.
- Hartimi i planeve rregullative urbane për zonat pyjore.

*Rehabilitimi i objekteve të banimit kolektiv*

- Rehabilitimi i kulmeve në objektet e banimit kolektiv për të siguruar një infrastrukturë të sigurt dhe të qëndrueshme.
- Rregullimi dhe rehabilitimi i korridoreve (përfshirë lyerjen) në objektet e banimit kolektiv për ta përmirësuar estetikën dhe funksionalitetin e hapësirave të përbashkëta.

Këto aktivitete janë të fokusuara në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe ndërtimin e një infrastrukture urbane që reflekton zhvillimin modern dhe nevojat e qytetarëve.

## 7. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me realizimin e këtij programi synon arritjen e këtyre objektivave të përgjithshme:

- Shfrytëzimi efikas dhe i qëndrueshëm i tokës bujqësore dhe resurseve tjera natyrore;
- Rritja e prodhimit në fermë duke përmirësuar zinxhirin e vlerës;
- Rritja e mbështetjes financiare për fermat;
- Krijimi i mundësive të punësimit në zonat rurale, veçanërisht përmes diversifikimit rural.

*Projektet Kapitale:*

- **Rehabilitimi i kanaleve ujtëse dhe kullimi i tokave** – Planifikohet të sigurohet një rrjet efektiv ujitës për bujqësinë dhe të përmirësohen kushtet e kullimit.
- **Riparimi i rrugëve fushore** – Rrugët rurale do të riparohen për ta lehtësuar qasjen në tokat bujqësore dhe zonat rurale.

- **Ndërtimi i strehimores për qentë endacakë** – Synohet ndërtimi i një strehimoreje moderne për menaxhimin dhe mirëqenien e kafshëve endacake.

*Projektet me Bashkëfinancim:*

- **Ngritja e pemishteve me pemë të imta** – Përmes bashkëfinancimit, fermerët do të mbështeten për krijimin e pemishteve me prodhimtari të lartë.
- **Furnizimi me mekanizim bujqësor** – Sigurimi i pajisjeve moderne për përmirësimin e proceseve bujqësore.
- **Ngritja e serrave** – Ndihmë për fermerët në krijimin e serrave për prodhim të qëndrueshëm bujqësor.
- **Hapja e puseve** – Përmirësimi i furnizimit me ujë për nevoja bujqësore dhe të tjera.
- **Ngritja e pemishteve me pemë arnore** – Mbështetje për zhvillimin e sektorit të frutave arnore.

*Projektet për Mallra dhe Shërbime:*

- **Insemenimi artificial i lopëve dhe vaksinimi i deleve e dhive kundër sëmundjeve infektive** – Mbështetje për rritjen e prodhimtarisë dhe parandalimin e sëmundjeve.
- **Trajtimi i qenve endacakë** – Kujdes dhe trajtim për menaxhimin e popullatës së qenve endacakë.
- **Vaksinimi i deleve kundër sëmundjes së brucelozës** – Përmirësimi i shëndetit të bagëtive dhe siguria e prodhimeve.
- **Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit dhe zonave periferike** – Masa për përmirësimin e higjienës publike.
- **Hartimi i projekteve për fermerët për grante** – Mbështetje për aplikime në grante dhe zhvillim të projekteve bujqësore.
- **Matjet gjeodezike për nevoja të drejtorisë** – Përgatitje për projekte të ndryshme zhvillimore në zonat urbane dhe rurale.

*Subvencionet:*

- **Subvencionimi i sektorit të shpendarisë** – Mbështetje për prodhimin e vezëve dhe zhvillimin e sektorit të shpendarisë.
- **Subvencionimi i sektorit të bletarisë** – Promovimi i prodhimit të mjaltit dhe produkteve të tjera të bletarisë.
- **Subvencionimi i deleve dhe dhive** – Mbështetje për rritjen e prodhimtarisë në sektorin e bagëtive të imta.
- **Subvencionimi i sektorit të qumështit** – Përmirësimi i prodhimit dhe cilësisë së produkteve të qumështit.

Këto projekte janë të planifikuara në bazë të nevojave të qytetarëve dhe buxhetit të miratuar, duke siguruar një zbatim të harmonizuar dhe të qëndrueshëm gjatë gjithë vitit.

## 8. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Plani i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit përcakton objektivat, prioritetet dhe aktivitetet, duke synuar zhvillimin e qëndrueshëm kulturor, promovimin e rinisë dhe avancimin e sportit në komunitet.

*Objektivat kryesore:*

- Investime në infrastrukturën sportive, kulturore dhe rinore.
- Përmirësimi i infrastrukturës së brendshme të institucioneve vartëse të drejtorisë.
- Ngritja e nivelit të monitorimit dhe raportimit për projektet.
- Regjistrimi i Prizrenit në Agjencinë Ndërkombëtare të Festivaleve.
- Mbështetja e Ansambleve të qytetit për ngritjen e performancës së tyre.
- Avancimi i bashkëpunimit me OJQ-të, klubet sportive dhe aktorët e tjerë.
- Subvencionimi i klubeve sportive sipas kritereve.
- Mbështetja e projekteve kulturore, sportive dhe rinore me interes për qytetin.
- Promovimi i vetëdijes qytetare për kulturën, trashëgiminë dhe shëndetin.
- Respektimi i kalendarit të festave kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Fuqizimi i stafit të DKRS-së dhe institucioneve vartëse.
- Përcjellja dhe monitorimi i investimeve kapitale.

Objektivat dhe aktivitetet sipas sektorëve:

*Spektori i kulturës*

*Veprimtaria Botuese*

- Krijimi i një ueb faqeje kulturore dhe letrare që do t'i pasqyrojë të gjitha aktivitetet e DKRS-së dhe OJQ-ve për vitin 2024.
- Botimi i pesë ose më shumë titujve nga autorët vendës (thirrja hapet në muajin Maj).

*Aktivitetet Kulturore Tradicionale*

- Festivali i Këngës së Vjetër Qytetare “Zambaku i Prizrenit” (qershor/korrik).
- Gara Komunale e Recituesve të Rinj (prill).
- Festivali i Këngës së Fëmijëve (1 qershor).
- Spektakli për festat e Vitit të Ri (dhjetor).
- Koncert në sheshin “Shatërvan” (dhjetor).
- Ekspozita e Nëntorit dhe Çmimi për artin pamor (nëntor).
- Ditët e Kulturës (Maj-Tetor) duke mbajtur koncerte, ekspozita, panairë kulturore dhe aktivitete të ndryshme artistike.
- Takimet me mërgimtarët (korrik/gusht).
- Kinemaja e hapur në bashkëpunim me Kino Lumbardhin dhe Doku Kino (shtator-tetor).
- Dita e Muzikës Klasike (shtator-tetor).

*Kremitimi i Festave Kombëtare dhe Ndërkombëtare*



- Dita e Pavarësisë (17 shkurt).
- Dita e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Dita e Çlirimit (10-12 qershor).
- Dita e Flamurit Kombëtar (28 nëntor).

#### *Institucionet Vartëse të Kulturës*

- Pasurimi i fondit të bibliotekës dhe organizimi i aktiviteteve si Java dhe Dita e Bibliotekës.
- Mbështetja e qendrave kulturore dhe realizimi i tri premierave të reja nga Teatri i Qytetit.
- Furnizimi i Ansambleve Artistike me kostume dhe vegla muzikore.

#### *Nxitja e Krijimtarisë Artistike*

- Mbështetja e talentëve të rinj përmes projekteve të subvencionuara.
- Pjesëmarrja e trupave artistike në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare.

#### *Sektori i sportit*

- Subvencionimi i klubeve sportive për sport cilësor.
- Masovizimi i sportit përmes garave shkollore dhe turneve tradicionale.
- Organizimi i turneve të futbollit kushtuar figurave të shquara si “Përparim Thaçi” dhe “Zenun Çoçaj”.
- Mirëmbajtja dhe rregullimi i fushave sportive.
- Organizimi i manifestimit “Sportisti i Vitit 2025”.
- Bashkëpunimi me qytete dhe shtete të tjera.

#### *Sektori i rinisë*

- Fuqizimi i të rinjve përmes aktiviteteve edukative, kulturore dhe sportive.
- Promovimi i pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje.
- Organizimi i tribunave kundër dukurive devijante, kuizeve të diturisë dhe aktiviteteve shoqërore.
- Mbështetja e organizatave rinore dhe projekteve që ndikojnë pozitivisht në komunitet.
- Avancimi i bashkëpunimit me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare për zhvillimin e politikave rinore.

Plani për vitin 2025 synon të krijojë një mjedis të pasur me aktivitete kulturore, sportive dhe rinore, duke promovuar vlerat e qytetit të Prizrenit dhe duke mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm të tij.

### **9. Drejtoria e Inspektorateve**

Drejtoria e Inspektorateve gjatë vitit 2025 do të realizoj planin e punës sipas ligjeve në fuqi, objektivave të vendosura nga sektorët që veprojnë në këtë drejtori.

### *Sektori i Tregut*

#### Përqëndrimi dhe Objektivat:

- Vazhdimi i punës për inspektimin dhe mbikëqyrjen e bizneseve dhe luftimin e informalitetit.
- Zbatimi i ligjeve të reja dhe ekzistuese, përfshirë mbrojtjen e konsumatorëve dhe sigurinë e produkteve.
- Inspektimi i bizneseve, tregjeve dhe aktiviteteve afariste, përfshirë atyre që shesin produkte të ndërtimit, ushqim dhe metale të çmuara.

#### Format e Veprimit:

- Inspektime të rregullta të dyqaneve, tregjeve dhe bizneseve për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve përkatëse.
- Bashkëpunim me sektorë të tjerë dhe institucione të sigurisë.

### *Sektori Komunal*

#### Mbikëqyrje e pastrimit dhe mbajtjes së rregullit në qytet:

- Monitorimi dhe menaxhimi i hapësirave publike.
- Kontrollimi i lokaleve për mbajtjen e hapësirave publike të rregullta dhe largimi i reklamave të paligjshme.

#### Mbrojtja e mjedisit dhe ndotjes:

- Inspektimi i operatorëve për menaxhimin e mbeturinave, ndalimi i deponive ilegale dhe mbrojtja nga ndotja.
- Monitorimi i masave për mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimi i lejeve mjedisore.

#### Inspektimi i Komunikacionit:

- Mbikëqyrja e transportit rrugor dhe kushteve për transportin publik si dhe kontrollimi i stacioneve të autobusëve dhe hapësirave të parkimit.

### *Sektori i Ndërtimit*

#### Inspektimi dhe kontrolli i ndërtimeve:

- Inspektimi rutinë i objekteve ndërtimore për ta siguruar qëndrueshmërinë dhe sigurinë.
- Ekzekutimi i masave për rrënimin e objekteve ndërtimore pa leje dhe shqyrtimi i ankesave për ndërtim.

#### Siguria dhe konsultime profesionale:

- Sigurimi i rregullave të sigurisë gjatë ndërtimit dhe ofrimi i mendimeve dhe udhëzimeve profesionale për ndërtimet.

## **10. Drejtoria e Emergjencave dhe Sigurisë**

Drejtoria e Emergjencave dhe Sigurisë për vitin 2025 ka planifikuar këto projekte dhe aktivitete në bazë të buxhetit të planifikuar:

### *Projektet Kryesore:*

- Vendosja dhe mirëmbajtja e kamerave të sigurisë në Komunën e Prizrenit
- Pajisje për Brigadën e Zjarrfikësve
- Dron i kërkim-shpëtimit për brigadën e zjarrfikësve
- Ndërtimi i mureve mbrojtëse për rrëshqitjet e dheut

### *Hartimi i Planeve:*

- Vlerësimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera.
- Hartimi i planit operativ emergjent lokal dhe planit të evakuimit për shkolla dhe objekte me rëndësi të veçantë.
- Plani për reagim emergjent ndaj rrëshqitjeve të dheut.
- Raportet e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë dhe raportet e inspektorëve të preventivës.

### *Qëllime dhe objektiva:*

- Rritja e kapaciteteve dhe cilësisë së punës në terren dhe përmirësimi i standardeve të sigurisë.
- Mbrojtja e jetës dhe pasurisë së qytetarëve të Komunës së Prizrenit, parandalimi i rreziqeve dhe aksidenteve.
- Trajnimi i stafit të Brigadës së Zjarrfikësve dhe përfaqësuesve të lagjeve, për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore.
- Përmirësimi i kushteve të punës për zjarrfikësit dhe rritja e numrit të stafit profesional.
- Funkcionalizimi i nënstacioneve të zjarrfikësve në Zhur, Gjonaj dhe Reçan.
- Inspektimi i shkallëve emergjente në banesat kolektive dhe bashkëpunimi me institucionet e sigurisë si FSK-ja dhe Policia.

### *Masat dhe Aktivitetet:*

- Inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme.
- Vërtetimi i pajisjeve dhe lëshimi i pëlqimeve nga AME-ja.
- Realizimi i ushtrimeve dhe trajnimeve për zjarrfikësit dhe stafin.
- Njoftimi i qytetarëve për alarme dhe mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore.

Ky plan ka si qëllim përmirësimin e sigurisë dhe mbrojtjes së qytetarëve si dhe rritjen e efikasitetit në përballimin e emergjencave.



## **11. Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik**

Plani i DTZHE-së synon ta mbështesë zhvillimin ekonomik të Komunës së Prizrenit përmes promovimit të turizmit, krijimit të një mjedisi të përshtatshëm për biznese dhe avancimit të infrastrukturës lokale. Ai përqendrohet në zbatimin e projekteve konkrete për rritjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin gjithëpërfshirës.

*Promovimi i mundësive për turizëm dhe zhvillim ekonomik në Komunën e Prizrenit*

- Dizajnimi dhe shtypja e materialeve promovuese.
- Organizimi i aktiviteteve ("Vera Kulturore", "Dimri Kulturor") dhe organizimi i panairit tradicional.
- Punëtori (teori dhe praktikë) për rikthimin e zejeve të zhdukura tradicionale.
- Pjesëmarrja në panaire.

*Zhvillimi i një ambienti të përshtatshëm për biznese*

- Ndërtimi i infrastrukturës në parkun ekonomik në Lubizhdë.

*Përkrahja për zhvillimin ekonomik në Komunën e Prizrenit, përmes zhvillimit të turizmit*

- Ndërtimi i infrastrukturës së turizmit malor dhe rural.
- Ndërtimi i infrastrukturës së turizmit kulturor.

## **12. Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit**

Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit fokusohet në ofrimin e shërbimeve efektive dhe të shpejta për qytetarët dhe institucionet, duke zbatuar politikën dhe ligjet në fuqi.

Objektivat kryesorë për vitin 2025 përfshijnë:

**Përfundimi i lëndëve brenda afateve ligjore** – Përpunimi dhe përfundimi i kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve brenda kohës së parashikuar ligjërisht.

**Thjeshtësimi i procedurave** – Lëshimi i certifikatave të pronës dhe dokumenteve të tjera kadastrale në mënyrë të menjëhershme në sportel.

**Realizimi i të hyrave** – Përbushja e planeve për të hyrat e përcaktuara nga kuvendi.

**Regjistrimi i komasacionit** – Rregullimi i regjistrimeve kadastrale për zonën Krushë e Vogël, në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Ky plan siguron që shërbimet e ofruara të jenë në përputhje me kërkesat e qytetarëve dhe institucionet, duke ruajtur efikasitetin dhe transparencën në çdo proces.

## **13. Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale**

Plani vjetor i punës për vitin 2025 i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është përpiluar në bazë të planit të aktiviteteve dhe planifikimit buxhetor për vitin 2025 të Komunës së Prizrenit. Ky plan përkufizon objektivat preliminare dhe periudhën e planifikuar kohore se kur do të realizohen projektet konkrete.

Kjo drejtori në bazë të kornizës buxhetore për vitin 2025, nga kategoria e shpenzimeve kapitale ka paraparë këto aktivitete:

- Ndërtimi i sallës për rekreacione sportive te shtëpia me bazë në komunitet për persona me aftësi të kufizuara dhe probleme të shëndetit mendor (projekt në vazhdim)
- Vazhdimi i ndërtimit të Qendrës së re për Punë Sociale
- Vazhdimi i ndërtimit të banesave sociale (Kulla 4)
- Rregullimi i infrastrukturës për ndërtesën e banesës kolektive në Petrovë
- Fillimi i ndërtimit të shtëpisë emergjente për mbrojtjen e fëmijëve
- Hartimi dhe përpilimi i projekteve të reja dhe projektimi i renovimit të projekteve ekzistuese
- Rregullimi i infrastrukturës për ndërtesën e QPS 2
- Ashensor për shtëpinë e të moshuarve
- Ashensor për shtëpinë 2 QPS

Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve drejtorja ka paraparë aktivitetet si në vijim:

- Furnizim me pako ushqimore dhe higjienike për rastet sociale dhe familjet skamnore
- Renovimi i banesave kolektive sociale Petrova (vazhdimi punimeve Kulla 3)
- Dezinfektimi, dezinfektimi, deratizimi dhe mbrojtja e perimetrit nga gjarpërinjtë në objektet e DPMS-së, shtëpitë rezidenciale dhe QPS-të
- Mirëmbajtja e oborreve dhe kopshteve në objektet e DPMS-së, shtëpitë rezidenciale dhe QPS-të
- Furnizimi me material ndërtimor për ndërtimin e shtëpive për familjet skamnore me çelësa në dorë
- Furnizimi me material ndërtimor për ndërtimin e kulmeve për familjet skamnore
- Furnizim me medikamente dhe material shpenzues sanitar për banorët e shtëpisë rezidenciale dhe shtëpisë së pleqve
- Furnizim me sistem të kamerave për objektet rezidenciale, QPS dhe DPMS
- Furnizimi me inventar, mobilje dhe pajisje për shtëpinë e pleqve
- Furnizimi me ushqim dhe pije për banorët e shtëpisë rezidenciale dhe shtëpisë së pleqve
- Furnizim me veshmbathje për shtëpinë rezidenciale dhe shtëpinë e pleqve
- Furnizim me mjete hixhienike për shtëpitë rezidenciale
- Fushatë mediale vetëdijesuese për parandalimin e fëmijëve në situatë rruge dhe punë të rëndë
- Furnizimi me inventar dhe mobilje për QPS 2 dhe shtëpinë rezidenciale
- Shërbimet e transportit për bartjen e fëmijëve dhe familjarëve të tyre
- Blerja e shërbimeve për kategori sociale
- Furnizim dhe montim i nyjeve sanitare për shtëpinë rezidenciale dhe QPS.

Gjithashtu, nga kategoria e subvencionimeve, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka paraparë aktivitetet si në vijim:

- Subvencionimi i familjeve të riatdhesuara për mbulimin e pagesës së qirasë
- Subvencionimi i qirasë për familjet skamnore të Komunës së Prizrenit
- Subvencionimi i OJQ-ve për projektet e fushave sociale
- Subvencionimi i familjeve strehuese që mbajnë fëmijë të braktisur
- Mbulimi i shpenzimeve të varrimit për të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit
- Furnizim me lëndë djegëse (dru) për familje të dëshmorëve, invalidëve të luftës së UÇK-së dhe rastet me vështirësi ekonomike
- Subvencionimi i pakove ushqimore dhe hixhenike
- Subvencionim i nënave që kanë lindur fëmijë gjatë vitit 2024

Strategjitë dhe programet komunale të cilat planifikohen të procedohen për miratim në asamblenë komunale gjatë vitit 2025, janë:

- Statuti QPS-së, shtëpisë së të moshuarve dhe Qendrës Rezidenciale
- Plani i veprimit për shërbimet sociale në Komunën e Prizrenit

---

Plani i punës së Kryetarit dhe drejtorive është plan dinamik pune, i cili mund të ndryshohet sipas kërkesave, nevojave dhe ndryshimit të rrethanave.

**KRYETARI I KOMUNËS SË PRIZRENIT,**

**Shaqir Totaj**

